



Datë 01.07.2024

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME  
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Upgrade i sistemeve të monitorimit të digave dhe mirëmbajta e tyre në Hec Fierzë, Koman, Vau i Dejës”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Shërbime të ndryshme – 98300000-6

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 250,000,000 (Dyqind e pesëdhjetë milion) Lek pa TVSH ose 2,493,019.55 (Dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 01/07/2024 është 100.28 Lekë/Euro.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
  - a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
  - b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

**Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklarimet” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa

*vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklaratimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.***

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

***Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:***

- a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”;

### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e risqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 27001:2013 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”** – Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurt dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Ky standard është kërkuar në përputhje

me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, shpërndarjen dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të ofrojë trajnim për përdoruesit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 3(tre) specialistë të diplomuar në një nga degët (Informatike / Teknologji-Informacioni ose Elektronike) të cilët të jenë të çertifikuar si më poshtë:

- 1) Të çertifikuar për ITIL Foundation ose të ngjashëm;
- 2) Të çertifikuar për Sistemet e Operimit Windws ose të ngjajshëm;
- 3) Të çertifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve;
- 4) Të çertifikuar si administrator Databaze;

**\*Sqarim:**

**Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një çertifikatë.**

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- *Diplomat e punonjëseve;*
- *Kontratat e punës;*
- *Çertifikatat;*
- *Listë pagesat E-SIG 25 për periudhën Prill 2024 - Qershor 2024 ku të jenë të përfshirë dhe punonjësit e mësipërm.*

**Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Në lidhje me punonjësit, argumentojmë si më poshtë :

*Diplomimi në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, shpërndarjen dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të ofrojë trajnim për përdoruesit si dhe mirëmbajtjen e tij.*

***Punonjësi i çertifikuar për “ITIL Foundation” ose të ngjashëm: Kjo çertifikatë vërteton që punonjësi ka njohuritë bazë në konceptet IT dhe shërbimet e dixhitalizimit. Duke qenë procesi i mirëmbajtjes së sistemit është mjaft specifik është i nevojshëm verifikimi i njohurive.***

**Punonjësi i çertifikuar për Sistemet e Operimit Windows ose të ngjajshëm:** Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi i certifikuar për Sistemet e Operimit është, pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë, sjelljen e programit të instaluar ne server dhe ne pajisjet fundore (Windows PC e përdoruesve) zgjidhjen e problematikave që mund të hasen gjatë instalimit dhe vijueshmërisë së punës, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë, në të gjithë hallkat funksionale të tij. Prania e tij jep garanci për ecurinë e sistemit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

**Punonjësi i çertifikuar menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve:** Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë, komponent e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit.

**Punonjësi i çertifikuar si administrator Database:** Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për krijimin dhe administrimin e databazës dhe mirëmbajtjen eficiente të saj. Kjo kërkesë lidhet me një nga detyrat kryesore të kërkuara nëpërmjet kësaj kontrate, konkretisht: Ngritja e databazës së sistemit me të dhënat historike dhe ato aktuale të matjeve. Aktivitetet e mirëmbajtjes për sistemin me të gjithë komponentët përbërës, duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik. Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për implementimin e detyrave të kontratës bashkë me shërbimet e mirëmbajtjes 36 mujore dhe operimin e sigurt me elementët përbërës të databazës.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë. Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi ka suportin teknik të tij për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen të prokurohen. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë zgjidhje teknike nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për zgjidhjen e ofruar.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme, është kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të paraqesin zgjidhje teknike mbi projektin/shërbimin e kërkuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për të siguruar Ak-në mbi mbështetjen dhe suportin e tyre.

***Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

***Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

***Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.***

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

KESH kërkon të realizojë këtë projekt, që ka për qëllim rehabilitimin e sistemeve automatike të monitorimit të digave të kaskadës së lumit Drin dhe mirëmbajtjen e tyre për tre vite ku për këtë nevojitet të kryhet zëvendësimi i paisjeve të dëmtuara dhe sigurimi i pjesëve rezervë që do të garantojnë mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemeve të monitorimit, për jo më pak se 3 vjet. Për këtë do të duhet të realizohet furnizim-vendosje dhe kalibrim i sensorëve të rinj në trupin e digës dhe në galeritë e tyre, furnizim-vendosjen dhe konfigurimin e datalograve të rinj, furnizim-vendosjen dhe konfigurimet për pesë PC të reja + software të menaxhimit të të dhënave për pesë digat e HEC-eve Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës dhe tre PC të reja për specialistët DVHT, furnizimin dhe instalimin e një software në një nga serverat ekzistues të DTIKA-server room në KESH qendër Tiranë, Software në KESH qendër Tiranë, do të konfigurohet që në mënyrë automatike dhe sipas një frekuence të caktuar, të importojë matjet nga PC-të e rinj të secilës digë dhe të krijojë mundësinë e përdorimit nga përdorues të ndryshëm që KESH do të krijojë për specialistët e tij në KESH Qendër Tiranë, të cilët do të kryejnë leximin e të dhënave të matjeve, përpunimet dhe interpretimin e tyre, krijimin e raporteve dhe grafikëve të ndryshëm sipas rastit. Përgatitja e dokumentit të specifikimeve teknike është kryer në bashkëpunim midis departamentit të Sigurisë së digave dhe departamentit të TIK dhe atij të Mirëmbajtjes. Eshte bazuar ne standardet ndërkombëtare për sisteme të tilla si dhe bazuar ne studimin e projektit të SOLEXPRT, implementuesit fillestar të sistemit. Kryesisht është ruajtur topologjia ekzistuese e rrjetit dhe pajisjeve duke përdorur sisteme të teknologjisë me bashkëkohore dhe Brenda standardeve për pajisje të tilla.

Njësia e Prokurimit